

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E INDUSTRISE, TRANSPORTIT DHE TREGETISE  
Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil

**UDHEZIM**

Nr. 26, Date ..24..9.96..1996

PER

**RREGULLAT PER FLUTURIMET CARTER DHE TAKSI  
PER DHE NGA SHQIPERIA**

Ne zbatim te Ligjit Nr. 7877 date 30.11.1994 "Per Aviacionin Civil", per te patur nje rregull ne dhenien e lejeve per kryerjen e aktiviteve te fluturimeve jo te planifikuara carter dhe taksi:

Udhezoi:

**1. Perkufizimet dhe zbatueshmeria**

**1.1 Perkufizime**

- "Fluturime Carter": Transport ajror komercial i paplanifikuar i pasagjereve, apo i mallrave do te quajme gjithe fluturimet te cilat nuk jane kryer per transport te pasagjereve apo mallrave me sherbim ajror te planifikuar.

- "Fluturime Taksi": Transport ajror komercial i pa planifikuar i pasagjereve, me avion te miratuar per transportin e 10 ose me pak pasagjereve ose per kargo me avion me mase maksimale te ngritjes 5700 kg ose me pak.

**1.2. Zbatueshmeria**

Keto rregulla aplikohen per fluturimet carter dhe taksi ndermjet Republikes se Shqiperise dhe botes me perjashtim te fluturimeve qe administrohen nga rregulla dhe ligje te vecanta si rrjedhoje e aderimit te Shqiperise ne Komunitetin European ne fushen e transportit ajror.

## **2. Rregulla te pergjithshme**

### **2.1. Lejet**

**2.1.1.** Fluturimet carter dhe taksi mund te kryhen vetem nga nje operator i autorizuar nga autoriteti i tij kombetar i Aviacionit Civil (D.P.A.C.). Kur i kerkohet, operatori duhet te vertetoje posedimin e ketij autorizimi dhe kompetencen e tij per te kryer transport ajror komercial nderkombetar ne baze te rregullave te vendosura nga Shteti i Operatorit dhe Standarteve e Praktikave Rekomanduese te ICAO-s, Aneksi 6, Pjesa I, (Deklarimi i kompetences).

**2.1.2.** Fluturimet carter dhe taksi mund te kryhen vetem me lejen e dhene nga Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil Shqiptar (D.P.A.C.), n.q.se nuk percaktohet ndryshe ne kete Udhezim. Leja nuk duhet te transferohet tek dikush tjeter.

### **2.2. Avionet**

Fluturimet carter dhe taksi mund te kryhen vetem me avionin e vet operatorit n.q.se nuk percaktohet ndryshe nga D.P.A.C.

### **2.3. Operatoret jo-shqiptare**

Per te mbrojtur interesat e transportit ajror shqiptar, D.P.A.C mund te kufizojte lejimin e nje operatori te huaj te kryeje fluturime sipas ketyre rregullave. Operatoret e huaj plotesojne formularin dhe dokumentat e Appendix A.

### **2.4. Statistikat**

Operatori eshte i detyruar t'i jape D.P.A.C te dhena statistikore mbi fluturimet e kryera n.q.se i kerkohen.

### **2.5. Siguracioni**

Per avionet e angazhuar ne fluturimet carter dhe taksi, vihet nje siguracion i detyruar ose ndonje garanci tjeter kundrejt demtimit te mundshem te pasagjereve dhe kargos (siguracioni i detyruar i transportit) si dhe kundrejt demtimit te personave ose pasurise jashte avionit (siguracioni i detyruar per palet e treta).

### **2.6. Cmimet**

Aprovimi i tarifes per dhenien e ketyre lejeve behet nga Ministri i Industrise, Transporteve dhe Tregetise. → *me Cehel*

## 2.7. Tarifat per dhenien e linjes

Tarifa per shfrytezimin e linjes ne transportin e planifikuar eshte 150000 Leke per linje dhe per transportin jo te planifikuar eshte 100000 Leke per cdo linje, per nje periudhe 3 ose 6-mujore.

Kerkesa per te operuar per ose nga territori shqiptar mund te refuzohet, ose leja e dhene mund te revokohet, n.q.se nuk jane paguar tarifat apo detyrimet.

Depozitohet nga operatori (kur ky eshte shqiptar), prane D.P.A.C ne fraksionin e numrit te llogarise se Ministrise se Industrise, Transportit dhe Tregetise, Dega e Thesarit Nr. Llog 11/131/01 shuma 10 U.S.D per pasagjere. } X  
21471

**2.8.** Shoqeria ajrore apo agjensia e udhetimeve, eshte e detyruar te mbuloje kostot e sherbimeve administrative te D.P.A.C, qe lidhet me qellimet e operimeve te saj.

**2.9.** Leja e ushtrimit te aktivitetit carter jepet e perkohshme deri ne 4 fluturime ne dy muaj per nje periudhe 3 ose 6 mujore me data te caktuara. Kerkesa behet tre muaj perpara. Leja mund te shtyhet kur: } X

- aktiviteti eshte ne interes te ekonomise kombetare dhe transportit publik nacional;
- ka zbatuar programin e investimeve; X
- eshte aktivitet me rentabilitet ekonomik;
- ka zbatuar programin e punesimeve dhe kualifikimeve te personelit shqiptar; X
- ploteson detyrimet ndaj paleve kontraktuese se D.P.A.C, Albtransporti, etj, dhe xhiron llogarite nepermjet Bankes se Shtetit Shqiptar. +

## 2.10. Marreveshja shumepaleshe

**2.10.1.** Operatoret ne shtetet, te cilat jane pale ne Marreveshjen shumepaleshe mbi te drejtat komerciale te sherbimeve ajrore te planifikuara ne Europe, Paris 30 Prill 1956, mund te kryejne fluturime ne baze te Marreveshjes me kusht qe shteti ne fjale te garantoje te njejtat te drejta per operatoret shqiptar.

**2.10.2.** Fluturimet sipas nen-aktit 1 te Nenit 2 te Marreveshjes mund te kryhen ne baze te ketij Udhezimi me kerkese paraprake. Perverc fluturimeve taksi dhe atyre humanitare ose ne raste emergjence, njoftimi duhet t'i jepet D.P.A.C. jo me vone se 48 ore perpara kryerjes se fluturimit.

Njoftimi duhet te permbaje te njejtat te dhena sic kerkohet per aplikimin ne kete Rregullore.

**2.10.3.** Fluturimet sipas ketij udhezimi mund te kryhen vetem me miratimin paraprak sipas limiteve kohore per aplikim dhe kushteve qe cilesohen ne kete rregullore.

### **3. Fluturimet carter per pasagjere**

**3.1.** Aktiviteti Ajror Tregtar Carter me nisje nga Shqiperia kryhet vetem me leje dhe ne perputhje me dokumentacionin e kerkuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil.

**3.2.** Ushtrimi i aktivitetit ne kushtet e kontrates se qirase per avionin dhe ekuipazhin realizohet kur:

- ekziston kontrata e qerese me nje shoqeri ajrore qe krijohet bindje;
- vertetohet dokumentacioni i avionit dhe ekuipazhit;
- ekziston siguracioni i avionit dhe pasagjerit per fluturimin qe kryhet;
- depozitohet ne Banken e Shtetit Shqiptar shuma per dy fluturime avance, per numrin e vendeve te avionit dhe cmimin e biletës si garanci.

**3.3.** Shitja e biletave garantohet nepermjet kontratave **me agjensi ajrore qe kane license te IATA-s,** nepermjet nje komisioni 8-12 % te vlefes se biletës.

### **3.4. Procedura dhe limitet kohore per aplikim**

Kerkesat per fluturime carter i drejtohen D.P.A.C, nje muaj perpara. Kerkesat per fluturime carter turistike nderkombetare per dhe ne destinacionet e tjera, do t'i drejtohen D.P.A.C.

**Tabela**

Kategoria e Carterit	Te gjitha fluturimet	Maksimumi i 4 fluturimeve ne 2 muaj	Me teper se 4 fluturime ne 2 muaj
Turistik per-dorim vetjak Student Raste speciale		48 ore	Programi veror 15 Jan. Programi dimer. 1 Shtat
Grupe qe njihen	Brenda Europes 15 dite Jashte Europes 30 dite		

**3.2. Formati dhe permbajtja e kerkeses**

3.2.1. D.P.A.C mund te kerkoje qe kerkesa dhe dokumentacioni te paraqiten ne shqip ose ne Anglisht. Gjithashtu mund te kerkoje nje formular aplikimi special.

3.2.2. Kerkesa duhet te permbaje keto te dhena:

- a- emrin, adresen, numrat e telefonit, teleksit, faksit te operatorit
- b- tipin e avionit, shenjat e kombesise dhe te regjistrimit.
- c- siguracioni i pikes 2.5 (D.P.A.C mund te kerkoje dokumente te tjera).
- d- emrin, adresen, numrat e telefonit. teleksit, faksit te cdo carteruesi.
- e- daten dhe planin e fluturimit e shenjen e thirrjes
- f- kategorine e carterit

Te gjitha plotesojne formularin e appendix A bashkengjitur.

Per fluturimet, single, dhe transit nga jashte me destinacion Shqiperine aplikohen kerkesat e AIC A 11/90 te SEP 6, e dhene kjo tek Appendix 1 Te dhenat shtese kerkohen per kategorite e ndryshme te carterave, si me poshte.

**3.2.3. Fluturime carter turistike**

**3.2.3.1.** Aplikanti duhet te paraqese broshurat e organizuesit te udhezimit turistik tek D.P.A.C per informim.

**3.2.3.2.** Aplikanti duhet te mbaje dhe t'i paraqese D.P.A.C nje dokument me te dhenat e pjesemarresve dhe:

- a- emrin e operatorit;
- b- numrin e fluturimit;
- c- piken e nisjes dhe te zbritjes;
- d- emrin, adresen dhe numrin e telefonit te organizuesit te turit;
- e- emrat e pasagjereve ne rend alfabetik;
- f- pasagjeret pa pagese, te shenuar vecmas;

Cdo grup pasagjeresh duhet te shenohet vecmas duke percaktuar destinacionin, daten dhe numrin e fluturimit ne ikje dhe ne kthim. N.q.se transportohen grupe pasagjeresh nga disa organizues te ndryshem, kjo duhet te specifikohet.

**3.2.4. Fluturimet carter per perdorim vetjak**

**3.2.4.1.** Kerkesa duhet te shoqerohet me nje deklarate, e cila tregon qe fluturimi ka nje karakter vetiak.

**3.2.5. Fluturimet per ngjarje speciale**

**3.2.5.1.** Kerkesa duhet te permbaje te dhena persa i perket:

- a- llojit te ngjarjes dhe daten;
- b- rregullimet

**3.2.6. Fluturimet carter te grupeve te ngjashme qe njihen**

**3.2.6.1.** Kerkesa duhet te shoqerohet me nje deklarate, si ne Apendix A, e cila tregon se fluturimi ka karakter te tille, n.q.se avioni carterohet nga disa grupe, duhet te paraqitet nje deklarate nga cdo grup.

**3.2.6.2.** Sipas kerkeses, duhet te paraqitet ky dokumentacion shtese:

- a- nje liste e pjesemarresve ne rend alfabetik
- Kur ka disa grupe, pasagjeret duhet te grupohen vecmas  
Pasagjeret pa pagese radhiten vecmas
- b- nje kopje te kontrates se carterit
  - c- statuti i asosacionit (grupit)

- d- raport vjetor
- e- liste e anetareve

### 3.2.7. Te dhena dhe dokumentacion suplementar

D.P.A.C, ne raste te posacme, mund te kerkoje te dhena dhe dokumentacion plus atyre qe kerkohen per sa me siper.

### 3.3. Kushtet per fluturimet carter

#### 3.3.1. Fluturimet nga Shqiperia per jashte

**3.3.1.1.** Lejet jepen nga D.P.A.C per fluturimet me destinacion ne Europe dhe per vendet Mesdhetar e jashte Europes.

**3.3.1.2.** I tere kapaciteti i avionit duhet te carterohet nga nje ose disa organizues udhetimesh per transportin jashte dhe brenda vendit te grupeve turistike te planifikuara qe me pare.

#### 3.3.1.3. Nje fluturim carter turistik duhet te plotesoje keto kushte:

**a-** organizimi i turit, pervec kohes se udhetimit, duhet te perfshije te pakten 3 nete te plota nga te cilat njera nate duhet te jete nata ndermjet te shtunes dhe te dieles.

**b-** organizimi i turit duhet te permbaje edhe transportin per dhe nga destinacioni. Transporti ajror kerkohet vetem per nje rruge.

Akomodimi duhet te perfshihet per krejt periudhen e organizimit.

**c-** akomodimet e paspecifikuara duhet te behen vetem ne hotelet apo apartamentet e publikuara ne broshuren e turit, apo ne ndonje vend tjeter i te njejtit standard.

**d-** organizimi i turit nuk duhet te perfshije eskursionet me qendrim l nate ne destinacionet e pamiratuara per fluturimet carter turistike, seksioni

**f-** te gjitha pjesemarresit ne nje fluturim carter turistik me te njejtin organizator duhet te nisen dhe te kthehen se bashku.

**g-** nje perfaqesues i organizatorit te turit duhet te jete ne dispozicion te grupit ne piken e destinacionit.

8

**3.3.1.4.** Te gjithë pjesëmarrësit në një fluturim carter turistik duhet të paguajnë gjithë organizimin e turit. Nuk behet kthim parash për ndonjë pjesë të pashfrytëzuar të këtij organizimi.

**3.3.1.5.** Operatori është përgjegjës për kthimin e pasagjereve në atdhe të cilët i transportoi nga Shqipëria, pamvarësisht nga ndonjë prishje të marrëveshjes nga ana e carteruesit. Kthimi behet në aeroportin e nisjes. Përgjegjësia për kthimin mbaron, kur organizimi i turit përfshin transportimin me mjete të tjera transporti.

### **3.3.2. Fluturimet nga jashtë për në Shqipëri**

**3.3.2.1.** Lejet japen nga D.P.A.C për fluturimet nga pikat në Europë.

**3.3.2.2.** I tere kapaciteti i avionit duhet të carterohet nga një ose disa organizatore tëresh për transportimin jashtë ose brenda të personave të një organizimi turistik të planifikuar.

**3.3.2.3.** Një fluturim carter turistik duhet të plotësojë këto kushte:

a- Qendrimi, përveç kohës së udhëtimit, duhet të përfshijë të paktën 3 nete të plota. Për qendrimet që fillojnë të premten (weekend), vetëm 2 nete kerkohen.

b- Organizimi i turit duhet të përfshijë transportimin për në ose nga destinacioni në Shqipëri. Transportimi mund të kryhet me avion të charteruar vetëm një rrugë. Në drejtimin tjetër organizatori i turit (carteruesi) mund të zgjedhë mjete të tjera transporti. Akomodimi duhet të përfshihet për tërë periudhën e mbuluar nga marrëveshja.

c- Akomodimi i paspecifikuar mund të behet vetëm në hotelet ose apartamentet që përshkruhen në broshurën e turit, ose në vende të tjera të te njëjtit standard.

**3.3.2.4.** Pjesëmarrësit në një fluturim carter turistik duhet të paguajnë krejtësisht organizimin e turit. Nuk behet kthim parash për ndonjë pjesë të pashfrytëzuar të turit.

**3.3.2.5.** Operatori është përgjegjës për transportimin e pasagjereve nga jashtë në Shqipëri, pamvarësisht nga ndonjë prishje e marrëveshjes nga ana e carteruesit. Megjithatë, kjo nuk aplikohet për marrëveshjet e udhëtimit që përfshijnë transportin me avion të charteruar vetëm për një rrugë.

### 3.3. Pasagjeret per ne dhe nga Shqiperia ne te njeitin fluturim

Pasagjeret per ne dhe nga Shqiperia mund te transportohen me te njeitin fluturim carter turistik.

#### 3.3.4. Vetem transportimi

Ketu nenkuptohet transportimi ne nje fluturim carter turistik i pasagjereve, te cilet kane bere marreveshje vetem per transportin. Ky transportim behet per ne dhe nga Shqiperia sipas keture kushteve:

1. Deri ne 15% e kapacitetit te avionit mund te shfrytezohet nga pasagjeret qe kane marreveshje vetem per transportin. Kjo shifer nuk duhet te cenohet.
2. Ky transport kryhet si ne ikje ashtu edhe ne ardhje te nje fluturimi carter turistik. Nuk kerkohet udhetim vajtje-ardhje.
3. Transportuesi duhet te njoftoje D.P.A.C. per kete lloj marreveshje-transporti. Transportuesi duhet te jape informacion per kete sherbim.

**Verejtje:** Transportuesit duhet te kene parasysh qe ata jane te detyruar te marrin miratimin e autoriteteve te huaja kompetente perpara se te kryhet kjo lloj marreveshje-transporti.

### 3.4 Kushtet per fluturimet charter te perdorimit vetiak.

- 3.4.1. I tere kapaciteti i avionit duhet te prenotohet nga carteruesi.
- 3.4.2. Destinacioni i fluturimit duhet te percaktohet nga carteruesi.
- 3.4.3. Carteruesi duhet t'i pergjigjet te gjitha shpenzimeve te fluturimit, dhe pjesmarresit as direkt as indirekt nuk duhet ta rifondizojne ate.

**Verejtje:** Fluturimi qe nepermjet reklamave apo ndonje menyre tjeter i behet i ditur publikut, nuk miratohet.

### 3.5. Kushtet per fluturimet charter per student.

- 3.5.1. I tere kapaciteti i avionit duhet te prenotohet nga carteruesi, i cili duhet te jete nje institucion i njohur apo shoqate studentore.

### **3.5.2. Kane te drejte te marrin pjese keta persona:**

- a- Studentet (me shkeputje) nen moshen 30 vjec, te cilet jane regjistruar ne nje universitet, ne nje kolegji apo institut dhe te cilet deklarojne bursen studentore si dhe te diplomuarit, te cilet kane marre diplomen e tyre ne vitin kalenderik ne te cilen kryhet fluturimi.
- b- Nxenesit nga 12-22 vjec, te cilet arsimohen te pakten nje vit ne nje institut te njohur
- c- Trupi pedagogjik dhe persona te tjere ne rolin e drejtuesve te grupit
- d- Bashkeshortet dhe femijet nen 18 vjec te te siper permendurve ne pikat a) dhe c) kur shoqerojne ata.

### **3.6. Kushtet per fluturimet carter per ngjarje te vecanta**

**3.6.1.** Leje jepen per transportimin e grupeve pjesemarrtese ne nje panair industrial ose ngjarjeve, sportive, fetare, kulturore e sociale.

**3.6.2.** I tere kapaciteti i avionit pronetohet nga nje ose disa carterues per transportin e pasagjereve qe marrin pjese ne te njejten ngjarje. Cmimi i pageses perfshin edhe pagesen e pjesemarrjes ne ate ngjarje.

**3.6.3.** Fluturimet nga brenda dhe nga jashte kryhen ne menyre te organizuar per te gjitha pjesemarrtesit.

### **3.7. Kushtet per fluturimet carter te grupeve qe njihen**

**3.7.1.** I tere kapaciteti i avionit duhet te pronetohet nga nje klub apo shoqate e ngjashme. N.q.se shoqata ka subjekte legale si anetare, keto mund te perfaqesohen me nje maksimum prej 3 personash secila.

**3.7.1.1.** Ne lidhje me fluturimet ndermjet Shqiperise dhe ndonje vendi tjeter europian nje avion mund te prenotohet bashkerisht nga tre shoqata. Shoqatat duhet te kene te njejtin qellim fluturimi.

**3.7.1.2.** Ne lidhje me fluturimet ndermjet Shqiperise dhe Amerikes se Veriut, kapaciteti i avionit mund te prenotohet nga Shoqata me kusht qe cdo carterues te kete prenotuar dhe paguar per te pakten 25 vende. Vendet e rezervuara per nje grup te vecante nuk duhet te perdoren per transportimin e personave qe nuk i perkasin grupit.

3.7.2. Nje Shoqate duhet te kete ekzistuar prej te pakten 1 viti para se te kryeje fluturimin. Shoqata duhet te kete karakter te perhershem dhe te kete nje qellim kryesor (jo organizimin e udhetimeve).

3.7.3. Pjesmarresit ne fluturim duhet te kene qene anetare te Shoqates prej te pakten 6 muajsh. Ata mund te marrin me vete bashkeshortin/en dhe femijet nen 18 vjec.

3.7.4. Anetaresia ne shoqate dhe lidhja familjare duhet te vertetohen.

**Verejtje:** Si verejtja ne 3.4.3

#### **4. Fluturimet carter me mallra**

4.1. Fluturimet carter me mallra, qe perfshijne transportin e mallrave ne lidhje me fluturimet carter te pasagjereve duhet te kryhen me kerkese tek D.P.A.C.

4.2. Ne rast tjetër kerkohen keto te dhena:

- a- emrin, adresen, numrin e telefonit, teleksit, faksit te operatorit.
- b- tipin e avionit, shenjat e kombesise dhe te regjistrimit.
- c- siguracionet e paragrafit 2.5.
- d- daten, planin e fluturimit dhe shenjen e thirrjes.

4.3. Njoftimi duhet te kete te pakten 48 ore para nisjes se avionit.

#### **5. Fluturimet taksi**

5.1. Fluturimet taksi mund te kryhen per transportimin e pasagjereve me kusht qe destinacioni te jete percaktuar nga charteruesi dhe asnje pjese e kapacitetit te avionit ti rishitet publikut.

5.2. Fluturimet taksi mund te kryhen pa bere kerkese por me njoftim tek D.P.A.C.

**Verejtje:** Asnje kusht i vecante nuk aplikohet per transportimin e kargos.

5.3. Kerkesat per nje fluturim ose deri ne tre fluturime, duhet te jepen 24 ore perpara.

## 6. Shkelja e rregullave.

6.1. Shkelja e rregullave per dhenien e lejeve mund te shkaktoje revokimin e lejes.

6.2. Shkeljet denohen sipas Ligjit te Aviacionit Civil, Neni 79, me gjobe, nderprerje te aktivitetit ose aplikikohet Kodi Penal nga organet perkatese.

6.3. Organizatoret e turit mund te denohen sipas rolit te tyre ne nxitjen e shkeljeve.

## 7. Ankimet

Ne rast se aplikanti kerkon te aplikojte kundrejt nje vendimi, ankimi duhet t'i jepet me shkrim D.P.A.C dhe te merret nga kjo administrate brenda 5 diteve nga data e marrjes se vendimit.

MINISTRE

SUZANA PANARITI



## 6. Shkelja e rregullave.

6.1. Shkelja e rregullave per dhenien e lejeve mund te shkaktoje revokimin e lejes.

6.2. Shkeljet denohen sipas Ligjit te Aviacionit Civil, Neni 79, me gjobe, nderprerje te aktivitetit ose aplikohet Kodi Penal nga organet perkatese.

6.3. Organizatoret e turit mund te denohen sipas rolit te tyre ne nxitjen e shkeljeve.

## 7. Ankimet

Ne rast se aplikanti kerkon te aplikojte kundrejt nje vendimi, ankimi duhet t'i jepet me shkrim D.P.A.C dhe te merret nga kjo administrate brenda 5 diteve nga data e marrjes se vendimit.

MINISTRE

SUZANA PANARITI

